REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E ARSIMIT E SHKENCËS DHE E TEKNOLOGJISË
MINISTARSTVO OBRAZOVANJA NAUKE I TEHNOLOGIJE
MINISTRY OF EDUCATION SCIENCE & TECHNOLOGY
SEKTORI I ARKIVËS-SEKTOR ARHIVE-ARCHIVE SECTOR
Njësia Org. / Org.Jedinica / Org Unit: 01B
Nr.Prot: / Broj Prot: / Prot.No: 725
Nr.i faqeve / Br.stranica / No.pages: 2
Data: / Datum: / Date: 19.05.2021
Prishtinë / a

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
***Qeveria – Vlada - Government***
***Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit***
***Ministarstvo Obrazovanja, Nauke, Tehnologije i Inovacija***
***Ministry of Education, Science, Technology and Innovation***

***Kabineti i Ministrit/Kabinet Ministra/Cabinet of the Minister***

Nr. 01B/39

Data: 19.05.2021

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit në mbështetje të nenit 8, 10 dhe 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, nenit 17 paragrafi 5 nenaragrafi 5.1 dhe 5.2, nenin 18 paragrafi 5, paragrafi 6 nënparagrafi 7.2 të Ligjit nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, nenit 8 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4, paragrafi 7 i shtojcës 1 i Rregullores (QRK) - nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e datës 30.03.2021, nxjerr këtë:

VENDIM

**Për shkarkimin e tre anëtarëve të emëruar nga MASHTI në Këshillin Drejtues të Universitetit Publik ''Ukshin Hoti'' në Prizren**

1. Shkarkohen anëtarët e Këshillit Drejtues të Universitetit Publik ''Ukshin Hoti'' të emëruar nga MASHTI me vendimin nr. 01-41 , të datës 17.07.2020 dhe vendimin nr. 01B-18 të datës 24.02.2021:

   1.1 Naser Bajraktari;
   1.2 Hajrija Skrijelj;
   1.3 Kushtrim Gashi.

2. Me këtë vendim shfuqizohet vendimi nr. 01-42 i datës 17.07.2020 dhe vendimi nr. 01B-18 të datës 24.02.2021.

3. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

**Arsyetim**

Duke u mbështetur në dispozitat e shënuara më lartë, raportin e punës dhe raportimeve të stafit akademik, anëtares së Këshillit Drejtues, raportimet e vazhdueshme të përfaqësuesve të studentëve për shkelje në Universitetit Publik ''Ukshin Hoti'', të reflektuara në dështim, refuzim, shpërfillje, paaftësi të vazhdueshme për të përmbushur detyrat e postit që ushtrojnë, ose për të vepruar në përputhje me parimet e përcaktuara në statutin e bartësit dhe në Ligjin nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, duke përfshirë ato të përcaktuara në nenin 17 të këtij ligji, obligimin e MASHTI-t për të emëruar përfaqësues të cilët duhet të jenë persona me reputacion të lartë publik, me aftësi përkatëse profesionale, afariste si dhe me aftësi të tjera praktike, u vendos si në dispozitiv të vendimit.

Vendimi i dorëzohet:

1. Të përmendurve më lartë;
2. Kabinetit të Ministres/MASHTI;
3. Zyrës së Sekretarit të përgjithshëm/MASHTI;
4. Universitetit Publik ''Ukshin Hoti'';
5. Departamentit të arsimit parauniversitar/MASHTI;
6. DALSH/MASHTI;
7. Arkivit/MASHTI.

**Arbërie Nagavci**

**Ministre/MASHTI**